



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 18.12.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen**  
**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 711, datë 23.11.2018 të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”
2. Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga 28 deputetë të Kuvendit të Republikës të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”
3. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj.

**Mungojnë:**

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Reme Lala, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

**Të ftuar:**

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhembli – Drejtore e Përgjithshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar

Ridvan Bode – kandidat për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë  
Suela Popa - kandidate për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë  
Edlira Luçi - kandidate për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë  
Artan Hoxha - kandidate për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë  
Arben Malaj – kandidat për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë  
Luljeta Minxhozi - kandidate për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

## HAPET MBLEDHJA

**Erion Braçe** – Hapet mbledhja e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave!

Siç ju lajmërova edhe më herët, ky komision do të marrë në shqyrtim kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave dhe nga grupe deputetësh në përputhje me ligjin. Në fillim do të nisim me propozimet e ardhura nga Këshilli i Ministrave me shkresën nr.38/3800, datë 04.12.2018. Këshilli i Ministrave ia ka përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë vendimin nr. 711, datë 23.11.2018 për propozimin e 3 anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Bazuar në VKM, propozohen të zgjidhen nga Kuvendi 3 kandidatë, përkatësisht: zonja Suela Popa, zonja Edlira Luçi dhe zoti Ridvan Bode.

VKM-ja është në përputhje me parashikimin e nenit 44, germa “b”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Sipas këtij neni, Kuvendi i Shqipërisë është organ zgjedhës dhe emërues i të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Mbështetur në propozimet e bëra nga organet propozuese që përcakton neni 44 i ligjit, me të drejtë rizgjedhjeje si më poshtë: 5 anëtarë propozohen nga Kuvendi, 3 anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave dhe 1 anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Siç e dini, në Bankën e Shqipërisë sot ka 6 vakanca, 3 që i përkasin Këshillit të Ministrave dhe 3 të tjera që i përkasin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në kriteret e ligjit për Bankën e Shqipërisë, neni 44, pika 3, e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” kandidatët për Këshillin Mbikëqyrës duhet të jenë persona që gëzojnë ndershmërinë dhe pastërtinë morale, si dhe kanë: arsimin e lartë ekonomik ose juridik, përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare, kualifikime profesionale të profilit, përvojë pune mbi 5 vjet në administratën publike ose në institucionet financiare dhe bankare. Të mos kenë pengesa të parashikuara në nenin 47. Plotësimi i kushteve të papajtueshmërisë së funksionit bazuar në nenin 46 të ligjit, funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës, të deputetit në Kuvendin e Shqipërisë apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionerit me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose

në subjekte që licencohen nga Banka e Shqipërisë. Afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, për guvernatorin dhe zëvendësguvernatorët është 7 vjet duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati, të çdo anëtari të Këshillit Mbikëqyrës të jenë të shpërndara gjatë periudhës 7-vjeçare.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, guvernatori dhe zëvendësguvernatorët mund të rizgjidhen, përveçse kur shkarkohen sipas rasteve të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji. Çdo kandidat që mund të zgjidhet anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë duhet të përmbushë secilin prej kushteve pa përjashtim të përcaktuar në nenin 44 e sa më lart, si dhe njëkohësisht ndaj çdo kandidati nuk duhet të vërtetohet asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 47.

Neni 47 i ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” liston bazën për të cilën duhen verifikuar rastet e papërshtatshmërisë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, si më poshtë: çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, duke përfshirë guvernatorin dhe zëvendësguvernatorin, pezullohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohet nga Kuvendi në qoftë se ai ose ajo është në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë sipas nenit 46; është dënuar nga gjykata për një vepër penale për të cilën ligji parashikon dënim me burgim; është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose është deklaruar i falimentuar dhe nuk është i rehabilituar; është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrojë veprimtari apo mjeshtëri; gjatë ushtrimit të detyrës në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

Këshilli i Ministrave ka kërkuar dokumentacion të kandidatëve që vërtetojnë plotësimin e kushteve ligjore, CV-në, dokumentin e diplomimit dhe kualifikimeve profesionale të fushës, dokumente që vërtetojnë vjetërsi në profesion, si dhe formularët e vetëdeklarimit që kandidatët nuk ndodhen në kushte të papajtueshmërisë, siç parashikon neni 47 i ligjit si dhe formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për dekriminalizimin”.

Mbi këto dokumente, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 8869, datë 23.12.97 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, Këshilli i Ministrave ka bërë vlerësimin individual të kandidatëve. Në relacionin e përcjellë Kuvendit të Shqipërisë janë paraqitur vetëm CV-të e kandidatëve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, të 3 kandidatët e propozuar përmbushin kriteret ligjore të arsimit profesional dhe akademik, si dhe përvojës profesionale në sistemet bankare e financiare për këtë kandidim, që do të thotë se zoti Ridvan Bode përmbush kriteret ligjore bazuar në kriterin

e përvojës në punë, funksioneve të larta në kabinetet qeveritare duke mbajtur pozicionin e ministrit të Financave për 9 vjet në periudha të ndryshme qeverisëse, deputet në 5 legjislatura, master dhe Doktor i Shkencave Ekonomike.

Pikërisht për këto arsye, ndodhet sot para Komisionit të Ekonomisë dhe Financave zoti Ridvan Bode.

Zoti Bode, do të donim prej jush një prezantim të shkurtër jo të jetëshkrimit, por më tepër të vizionit tuaj për të kryer detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe më pas do t'ju luteshim që të pranoni pyetje dhe të na jepni përgjigje në rast se kolegët do të jenë të interesuar.

Fjala për ju!

**Ridvan Bode** – Ju faleminderit!

**Erion Braçe** - Më falni, zoti Bode!

Do t'ju lutesha shumë medias, duke qenë se ambienti është shumë i ngushtë, të mos lëvizni më nëpër sallë!

**Ridvan Bode** – Ju faleminderit!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ndihem i nderuar që vij para jush me një vlerësim për një propozim për anëtar të bordit të Bankës së Shqipërisë! Ju garantoj që me eksperiencën dhe formimin tim profesional do t'i kontribuoj një debati konstruktiv në Bankën e Shqipërisë për të përmbushur të gjitha detyrimet ligjore që ka ky organ dhe për të krijuar një dinamikë të re që kërkon ekonomia e vendit në raport me zhvillimet në sferën bankare, monetare. Jam i bindur se me bordin e ri dhe me debatin që do të zhvillohet brenda, një pjesë të problematikave që vërehen sot, do të mund të marrin gradualisht një përgjigje gjithnjë e më pozitive.

Të gjithë kemi çmuar dhe çmojmë punën e bërë nga Banka e Shqipërisë në stabilitetin monetar të vendit dhe stabilitetin makroekonomik. Mendoj se jo vetëm eksperienca ime, por edhe formimi im si ekonomist dhe filozofik do të kontribuojë për një debat gjithnjë e më të shëndetshëm. Gjithsesi, nëse do të votohem, ky është vetëm fillimi për një kontribut edhe më të madh në këtë institucion. Sigurisht, unë e marr ftesën për të qenë pjesë e këtij institucioni i zhveshur nga të gjitha ngarkesat politike, pasi është një institucion tërësisht i depolitizuar dhe do të kontribuojë që ajo politikë që duhet të jetë në funksion të politikës monetare, duhet të jetë më e mira, më e drejta, më e balancuara për rrethanat e vendit. Sigurisht, unë kam formimin tim

ideologjik dhe orientimin tim filozofik dhe do të jem besnik i tyre dhe do të kontribuoj pozitivisht në këtë forum.

Faleminderit!

**Erion Braçe** - Faleminderit, zoti Bode!

Ka pyetje nga kolegët deputetë?

Dakord! CV-në e zotit Bode e keni përpara, angazhimet e tij janë shumë të qarta, kështu që në rast se nuk ka pyetje, atëherë, zoti Bode, jeni i lirë dhe mund të largoheni.

Faleminderit!

Të vijë kandidati tjetër.

Mirëdita!

Zonja Popa, jeni këtu për shkak të propozimit të Këshillit të Ministrave lidhur me të qenit kandidat për një vend vakant që i përket Këshillit të Ministrave në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Nga relacioni i përgatitur nga shërbimet e Kuvendit rezulton se në këqyrje të dokumenteve të paraqitura pranë Këshillit të Ministrave, të përcjella edhe Kuvendit, zonja Popa përmbush kriteret bazuar në kriterin e përvojës së punës, funksioneve që ka mbajtur në administratën publike ku veçohet eksperiencia e re 6-vjeçare në funksione të ndryshme në Bankën e Shqipërisë, si dhe një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh në sektorin bankar, po ashtu edhe arsimi juridik dhe ekonomik në certifikimet në fushën financiare.

Zonja Popa do të donim një prezantim dhe vizion tuajin lidhur me atë që ju mendoni në rastin kur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë mund t'ju japë të drejtën për të qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Më pas, në rast se do të ketë pyetje, do të jeni e lutur të jepni disa përgjigje në përmbushje të interesit edhe të kolegëve deputetë.

E keni ju fjalën.

**Suela Popa** – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në radhë të parë ju falënderoj për mundësinë që më dhatë të jem pjesë e kësaj seance dëgjimore!

Do të dëshiroja që prezantimin tim ta nisja me formimin akademik, më tej me eksperiencën profesionale dhe, sigurisht, në fund, me platformën.

Sa i përket formimit, kam përfunduar studimet ekonomike pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës me specializim në financë-bankë. Po pranë këtij fakulteti kam përfunduar edhe studimet në nivelin master në financë-bankë, ndërkohë kam përfunduar studimet në nivelin bachelor pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës. Gjatë kësaj kohe kam pasur mundësinë të kualifikohem dhe certifikohem nga institucione të ndryshme, ku dua të përmend edhe Ministrinë e Financave për sa i përket audituesit të brendshëm në sektorin publik, ndërkohë jam në fazën përfundimtare të certifikimit “Ekspert kontabël” nga një institucion ndërkombëtar.

Para se të filloj me prezantimin do të dëshiroja të theksoja se, duke marrë shkas edhe nga eksperiencia që kam pasur pranë bankës qendrore, konkretisht në Departamentin e Operacioneve Monetare, në sektorin e Marrëdhënieve me Qeverinë dhe administrimin e borxhit të jashtëm, në Departamentin e Mbikëqyrjes së Bankave dhe Institucioneve Financiare Jobanka, nga viti 2013, për një periudhë 4-vjeçare kam pasur nderin të drejtoj një nga institucionet më të rëndësishme në vend për sa i përket implementimit të politikave të zhvillimit rural dhe bujqësor në vend, ku përmes mbështetjes së pakushtëzuar të qeverisë shqiptare u bë e mundur përmbushja e të gjitha rekomandimeve nga Bashkimi Europian në kuadër të finalizimit me sukses të procesit të akreditimit, ku sot fermerët shqiptarë arrijnë të përfitojnë nga fondet komunitare.

Si fillim doja të theksoja se për sa i përket bankës qendrore, ku kam pasur edhe nderin të punoj, kemi të bëjmë me një nga institucionet më të rëndësishme në vend me reputacion të konsoliduar ndër vite ku u arrit me maturi dhe profesionalizëm të menaxhohen krizat financiare.

Gjithashtu, më lejoni të sjell në vëmendje se në përmbushje të kuadrit ligjor Banka e Shqipërisë ka vijuar të jetë transparente në politikat e ndjekura. Ka arritur të rikthejë besimin e publikut, pavarësisht skandalit të ndodhur në Departamentin e Thesarit dhe më e rëndësishmja ka arritur të ruajë të pacenuar pavarësinë e saj në bashkëpunim me qeverinë, institucione të tjera financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për përmbushjen e objektivit të përbashkët të stabilitetit financiar në vend.

Megjithatë, si në çdo institucion, edhe këtu ekzistojnë hapësira për përmirësime të vazhdueshme. Në qoftë se do të kisha nderin të isha një nga anëtarët e zgjedhura nga Kuvendi për të qenë pjesë e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, misioni im në përmbushje të këtij mandati do të fokusohet kryesisht në pikat e mëposhtme:

Së pari, konsolidimin e mëtejshëm të ekuilibrave makro-ekonomikë dhe financiar[ në vend përmes përmirësimit të transmetimit të politikës monetare me qëllim arritjen dhe ruajtjen e

stabilitetit të çmimeve dhe kontrollin e inflacionit. Kriza financiare globale nxori në plan të parë rëndësinë e stabilitetit financiar dhe demonstroi se vetëm objektivi i stabilitetit të çmimeve është i pamjaftueshëm për të garantuar stabilitet makro-ekonomik pa trajtuar me kujdes të veçantë çështjet e borxheve sovrane dhe deficiteve buxhetore.

Nga komuniteti i politikave monetare, ekspertët e fushës së bankave qendrore po diskutojnë gjithnjë e më tepër se ideja për të garantuar stabilitet financiar duhet forcuar përmes politikave makro-prudenciale.

Së dyti, në kuadër të stabilitetit të çmimeve dhe qëndrueshmërisë ekonomike, literatura, por edhe praktika financiare thekson rëndësinë e bashkëveprimit të sinkronizuar të politikës monetare me atë fiskale dhe buxhetore, sigurisht, pa cenuar pavarësinë e aktivitetit të Bankës Qendrore. Ndaj dëshiroj të theksoj rëndësinë e zbatimit të një politike monetare lehtësuese, shoqëruar me një konsolidim fiskal.

Gjithashtu, vihet re se, pavarësisht uljes së normës bazë të interesit nga banka qendrore, sërish efekti i transmetimit të politikës monetare nuk po ndjehet deri te konsumatori final. Një ndër shkaqet kryesore të sigurisë është shkalla e lartë e organizimit të ekonomisë dhe më konkretisht e reflektuar në depozitat dhe kreditë në valutë. Ndaj gjykoj si mjaft të rëndësishme vijimin e masave të ndërmarra nga banka qendrore për reduktimin e nivelit të eurizimit të ekonomisë duke ulur nivelin e ekspozimit të ekonomisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, ndërgjegjësimin të operatorëve të ndryshëm ekonomikë për të shmangur pozicionet e hapura dhe të pambrojtura valutore dhe për të rritur, sigurisht, përdorimin e monedhës vendase.

Nga ana tjetër, në qoftë se do t'i referoheshim situatës globale, një ndër shqetësimet kryesore të politikës monetare sot në botë është pikërisht fakti se, pavarësisht normave të ulta të interesit, pothuajse afër zeros, niveli i huadhënies mbetet ende në nivele anemike. Pavarësisht se kostot e huadhënies janë gjithnjë e më të lira, ende nuk po kontribuohet të targetohet inflacioni. Ekspertët e politikave monetare kanë filluar të përforcojnë idenë se metodat konvencionale nuk po japin rezultatet e dëshiruara, ndaj lind nevoja për ndryshime dhe për instrumente inovatore në funksion të zbatimit dhe transkriptimit më të mirë të politikës monetare të bankave qendrore në përputhje me realitetin ekonomik dhe sfidat aktuale.

Së treti, ashtu sikurse e përcakton edhe rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, në vijim dhe të strategjisë kombëtare për trajtimin e kredive me probleme, vihet re se, pavarësisht uljes së treguesit të kredive jo performuese, 25% në vitin 2014 ose më e ulta e 3 vjetëve të fundit, sipas

të dhënat të tetorit të vitit 2018, serish bankat e nivelit të dytë paraqiten konservatore në drejtim të ofertës së kredisë. Zgjerimi i shpejtë i portofolit të kredive me probleme dhe problemet e bankave me ekzekutimin e kolateralit në kushtet e mangësive ligjore dhe me vështirësitë që ka kaluar sistemi gjyqësor ndikojnë në dhënin e kredive nga bankat. Në të njëjtën kohë orientimi i vëmendjes së bankave në adresimin e kredive ekzistuese me probleme, procesi i përgjithshëm i uljes së ekspozimit të bankave të huaja dhe rritja e kundërshtisë së tyre nga rreziku pas krizës greke zvogëloi edhe më tej ofertën e tyre për kredi.

Do të dëshiroja të theksoja, gjithashtu, edhe ndryshimet e bëra në kuadrin rregullator european të mbikëqyrjes bankare, të cilat datojnë në vitin 2013 dhe u fokusuan kryesisht në forcimin e kërkesës për likuiditet dhe kapital të bankave mëma, të cilat kufizuan kështu hapësirat e bankave për të rritur ekspozimin në rajon, madje duke diskutuar nevojën për të tërhequr edhe nga një pjesë e rajonit. Sa më sipër, lind nevoja që Banka e Shqipërisë të rrisë dialogun me komunitetin bankar për të identifikuar dhe zgjidhur të gjitha pengesat dhe shqyrtuar alternativat e mundshme në drejtim të nxitjes së kreditimit të ekonomisë.

Së katërti, sugjeroj edukimin e publikut me kulturën financiare si një domosdoshmëri kur vendi po kalon procesin e integritetit në vendet e Bashkimit Europian. Dëshiroj të theksoj rëndësinë e komunikimit të politikës monetare në një gjuhë të kuptueshme për publikun e gjerë dhe jo për një rreth të caktuar akademikësh si një mundësi për të përmirësuar më tej mesazhet e përcjella nga politika monetare e bankës qendrore.

Nga ana tjetër, gjykoj të rëndësishëm intensifikimin e përpjekjeve nga banka qendrore për ndërgjegjësimin publik sa i përket përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave, por, gjithashtu, edhe risqet që shoqërojnë këto zhvillime.

Së pesti, sugjeroj ndërgjegjësim të publikut në përdorimin e monedhave virtuale, pavarësisht se konsiderohet si një rotacion financiar në ekspansion sa i përket përdorimit, lehtësirave në transaksion, përfitimeve që krijon paraja virtuale në kuadër të aksesit në financat globale. Gjykoj si emergjente hartimin dhe konsolidimin e kuadrit rregullativ në përdorimin e monedhave në vend, si një masë e domosdoshme në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit dhe stabilitetit financiar në vend. Ekspertët tregjeve financiare po shprehin gjithnjë e më shumë shqetësimin se në kushtet e mungesës rregullative transparencës dhe mbikëqyrjes, pavarësisht vlerave inovative, monedhat virtuale mund të provokojnë një krizë të re financiare.

Së gjashti, sugjeroj rishikimin e ligjit për Bankën e Shqipërisë dhe adresimin e të gjitha rekomandimeve të lëna në auditorët e jashtëm ose organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullativ mbi bazën e të cilit funksionon Banka e Shqipërisë.

Së shtati, sa i përket mbikëqyrjes bankare, unë sugjeroj monitorim rigoroz të kredimarrësve të mëdhenj me qëllim shmangien e rreziqeve nga ekspozimet e mëdha, identifikimin dhe trajtimin e kujdesshëm të grupeve të ndërlidhura. Fokus të veçantë u duhet kushtuar edhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me Bankën Qendrore Europiane, sa i përket metodologjive të mbikëqyrjes bankare, si hap i domosdoshëm në procesin e integritetit.

Së fundi, e shikoj si mjaft të rëndësishëm shtimin e përpjekjeve nga banka qendrore në drejtim të rritjes së kreditimit të sektorëve prioritarë në ekonominë shqiptare, siç është bujqësia, zhvillimi rural dhe turizmi. Kontributi i sektorit të bujqësisë në nivelin e punësimit dhe ndaj prodhimit të brendshëm bruto nuk është shoqëruar gjithmonë me të njëjtën mbështetje në buxhet nga shteti dhe nga sistemi bankar. Pavarësisht përpjekjeve maksimale të qeverisë shqiptare në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për krijimin e një fondi garancie në shërbim të fermerit dhe iniciativave private për investime në bujqësi dhe zhvillimin rural, sërish vihet re që bankat e nivelit të dytë kanë ndjekur një politikë mjaft konservatore.

Sa më sipër e vlerësoj se banka qendrore duhet të marrë masa për të orientuar dhe nxitur kreditimin bankar në sektorët prioritarë si promotor të zhvillimit ekonomik.

**Erion Braçe-** Faleminderit, zonja **Popa!**

A keni pyetje? Nuk keni.

Zonja Popa, prezantimin tuaj duhet ta depozitoni pranë sekretarisë së komisionit.

Të vijë kandidati tjetër!

Para komisionit ndodhet dhe do të dëgjojmë kandidaten e tretë për anëtar të Këshillit të Mbikëqyrjes, propozuar nga Këshilli i Ministrave, zonjën Edlira Luçi.

Nga dokumentet e depozituara në Kuvend nga ana e Këshillit të Ministrave, shqyrtuar nga Sherbimi i Monitorimit të Kuvendit, rezulton që kandidatja Edlira Luçi i përmbush kriteret ligjore, bazuar në kriterin e përvojës në punë, funksionet në fushën financiare dhe anëtare në shumë borde të organizmave ekonomiko – financiarë, me titullin akademik “Doktor i shkencave në fushën e ekonomisë” dhe “Profesor i asocuar”, lektore dhe përgjegjëse në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Financës në Fakultetin Ekonomik.

Zonja Luçi, jeni këtu për të bërë një prezantim tuajin personal, por edhe të vizionit tuaj lidhur me Bankën e Shqipërisë.

Në rast se kolegët deputetë do të kenë pyetje, jeni e lutur të na jepni përgjigje në lidhje me interesin e tyre.

**Edlira Luçi** - Faleminderit për ftesën në këtë dëgjese!

Në dosjen që unë kam dorëzuar në përgjigje të thirrjes për aplikim kam sqaruar me detaje karrierën dhe aktivitetin profesional që lidhen me çfarë prezantoi kryetari. Kështu që nga momentin që kam përfunduar studimet e larta kam filluar punë si pedagoge pranë Departamentit të Financës. Pra, prej 21 vjetësh punoj pranë Departamentit të Financës në Fakultetin e Ekonomisë, ku kam qenë e angazhuar kryesisht në mësimdhënie në lëndë të karakterit financiar, investime financiare, këshillim dhe vendimmarrje financiare, por pa lënë pas dore të gjitha kërkesat dhe detyrimet për kualifikimin tim profesional, si edhe pjesëmarrjen aktive në organe të ndryshme drejtuese të fakultetit. Kam qenë dhe jam pjesë e organeve të ndryshme të njësisë bazë ku unë punoj, si dhe të njësisë kryesore të fakultetit. Kam qenë pjesë e hartimit dhe menaxhimit të departamentit dhe fakultetit, të projekteve të materializuara në programe të reja mësimore për studentët e degës së financës, kryesisht në funksion të ciklit të dytë të studimeve, pra nivelit master. Është për t'u përmendur që programet e reja të ofruara nuk janë ofruar thjesht për të shtuar numrin e programeve që departamenti që unë drejtoj ofron, por për të përafruar studentët më mirë me tregun aktual të punës. Mund të përmend masterin në bashkëpunim me universitetin e Torinos, i cili ka kurrikulat më të mira në rajon dhe Europë, me kompaninë Deloitte, për t'iu ofruar studentëve mundësinë e ekuivalentimit të diplomës së përfutur në universitetin e ekonomisë me diploma të universiteteve prestigjioze europiane. Gjithashtu, gjatë 6 vjetëve të drejtimit të departamentit kam synuar të qëndroj pranë institucioneve të ndryshme financiare në vend duke nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me interes dypalësh për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, për hartimin e kurrikulave të reja në funksion të punës së këtyre institucioneve, të organizimit dhe orientimit më të mirë të praktikave të studentëve dhe të realizimit të projekteve të përbashkëta. Krahas aktivitetit të mësipërm jam munduar të jap kontributin tim modest në angazhimin tim si anëtare e bordeve të disa institucioneve financiare të lidhura ngushtësisht me sektorin bankar, kam qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që në momentin e krijimit të këtij institucioni; kam qenë anëtare e këshillit të bursës së Tiranës për një kohë relativisht të kufizuar, jam aktualisht anëtare e

Këshillit Mbikëqyrës të Trajtimit të Kredive. Duke vlerësuar shumë pozicionin e propozuar dhe duke e konsideruar me shumë përgjegjësi funksionin që duhet të kryej një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, do të doja që në mënyrë të përmbledhur të ndalesha në sa më poshtë:

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka një gamë të gjerë detyrash të përcaktuara qartësisht nga ligji dhe që lidhen me funksionet kryesore të bankës, si ai i politikës monetare, menaxhimi i rezervës valutore, mbikëqyrjes bankare e stabilitetit financiar, po dhe me funksionet e tjera si ai i emetimit të parasë dhe pagesave.

Bazuar në ligjin e Bankës së Shqipërisë, Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, është përgjegjës për hartimin e politikës monetare dhe për miratimin e udhëzimeve për zbatimin e saj, gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vendos për politikat e administrimit në përgjithësi si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë duke siguruar kështu një administrim të drejtë të institucionit dhe përgjegjshmërinë kundrejt publikut për veprimet, angazhimin dhe rezultatet e saj. Respektimi i kompetencave, detyrave dhe përgjegjësi të sanksionuara në këtë ligj për Këshillin Mbikëqyrës si dhe në statutin dhe rregulloret e institucionit do të jenë në fokus në punën time. Në kushtet e kryerjes të një pune të konsiderueshme dhe të vlerësueshme nga stafi i Bankës së Shqipërisë hartimi i një dokumenti udhërrëfyes për të ardhmen, strategjia afatmesme për zhvillimin e Bankës së Shqipërisë për periudhën 2018-2020 mendoj që puna për realizimin e objektivave të kësaj strategjie ka qenë gjatë vitit 2018 dhe do jetë gjatë 2 vjetëve të tjerë 2019-2020 fokusi kryesor i Bankës së Shqipërisë. Në këtë dokument janë detajuar objektivat për secilën fushë dhe janë vendosur afatet për realizimin e tyre. Ndjekja e realizimit të objektivave të vendosur në këtë strategji të Bankës së Shqipërisë, në gjykimin tim, do të ishte një nga fokuset kryesore të Këshillit Mbikëqyrës krahas detyrave të tjera funksionale që i jep ligji dhe aktet e tjera rregullative të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, mendoj së një tjetër fokus i institucionit, si dhe i Këshillit Mbikëqyrës në plan afatshkurtër do të jenë konkluzionet e propozuara nga FMN, në nëntor të 2018 dhe më specifikisht ulja e mëtejshme e kredive me probleme, sigurimi dhe garantimi i ruajtjes së cilësisë në sektorin bankar, zhvillimi i tregjeve financiare, strategjia e deeuroizimit, forcimi i masave dhe bazës rregullative kundrejt parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në funksion të forcimit të sistemit financiar.

Gjithashtu, në fokus të institucionit duhet të jenë dhe detyrat e lëna ndaj institucionit nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017, miratuar më 17 maj të vitit 2018. Do të veçoja ndër detyrat e lëna përmirësimin e mëtejshëm të funksionit mbikëqyrës, të bazuar në rrezik, si dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar të subjekteve të mbikëqyrura.

Një tjetër detyrë e lënë, të cilën, në fakt, e shikoj me shumë interes është ndërmarrja e hapave konkretë në bashkëpunim me institucionet e tjera mbikëqyrëse të tregjeve financiare për përmirësimin e ecurisë së tregut primar dhe zhvillimin e tregut dytësor, ekzistenca e të cilit do të shtonte mundësinë e investimit dhe do të ofronte një kanal të rëndësishëm për sigurimin dhe likuiditetin në ekonomi.

Në fokus të Bankës së Shqipërisë në mënyrë të vazhdueshme duhet të jetë edhe orientimi i sistemit financiar drejt kredithënies ndaj atyre sektorëve potencialë të ekonomisë, të cilët kanë më shumë kërkesë dhe më pak risk në mënyrë që likuiditeti i tepërt të përkthehet në mënyrë të shëndetshme për ekonominë duke ndjekur paralelisht planin e masave ndaj trajtimit të kredive me probleme. Mendoj, gjithashtu, që në fokusin e institucionit afatshkurtër e afatmesëm duhet të jetë dhe nxitja e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave përveç aktiviteteve të edukimit, të cilat organizohem në mënyrë të përvitshme, siç është java e edukimit financiar, materialeve edukuese të publikuara, por mund të gjenden dhe forma të tjera për promovimin e instrumenteve të tillë.

Ju falënderoj për kohën dhe vëmendjen tuaj.

**Erion Braçe** – Faleminderit, zonja Luçi!

A ka pyetje nga kolegët?

Vetëm një gjë kam unë, lidhur edhe nga sa thatë ju, zonjë, mendoj që në momentin që ju jeni anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë do të duhet që këto angazhimet e tjera që lidhen me bordet siç thatë, duhen ezauruar në raport me konfliktin e interesave.

**Edlira Luçi**- Patjetër jam e interesuar.

**Erioni Braçe**- Atëherë shumë faleminderit për prezantimin tuaj!

**Edlira Luçi**- Ju faleminderit!

**Erion Braçe** - Vazhdojmë me kandidatët e propozuar nga Kuvendi.Mirëdita!

Zonja Luljeta Minxhozi, pas interesit tuaj në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në referencë të thirrjes drejtuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ju keni bërë një prezantim

tuajin në një mbledhje të përbashkët me të gjithë deputetët nën drejtimin e sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit. Pas mbledhjes, ju sqaruam se kandidatura juaj mund të vijonte më tutje konkurrimin për vendin vakant në Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë në rast se do të mbështetej me 22 firma nga ana e deputetëve. Dje, Kuvendi ka marrë një propozim nga një grup deputetësh që i plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kushtetuese të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga ligji për Bankën e Shqipërisë dhe tashmë jeni një nga kandidatet e propozuara nga grupet e deputetëve për të qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Pikërisht, për këtë arsye ndodheni para këtij komisioni, për të na parashtruar edhe një herë, sepse procedura e kërkon në këtë mënyrë, vizionin tuaj lidhur me këtë rol në Bankën e Shqipërisë. Natyrisht, në qoftë se kolegët deputetë do të kenë ndonjë pyetje, të na jepni disa përgjigje lidhur me interesimin e tyre.

Fjala për ju.

**Luljeta Minxhozi** – Shumë faleminderit!

Falënderoj të gjithë deputetët që besuan në projektin tim si kandidate për Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë!

Do t'ju jem shumë mirënjohëse në qoftë se ky pozicion do të më jepet për shkak se besoj shumë që e gjithë e kaluara ime si një akademike në fushën e studimeve ekonomike, kryesisht në makro-ekonomi, do të kontribuonte fort në stadin e ri në të cilin ka hyrë Banka e Shqipërisë, hap, të cilin e ka hedhur, duke projektuar dhe ndërtuar një strategji të re për vitet 2018-2020.

Fokusi i strategjisë është shndërrimi i Bankës së Shqipërisë në një institucion, i cili mund të bëjë parashikime ekonomike. Besoj se ky është funksioni i ri i Bankës së Shqipërisë, e cila deri tani ka ndërtuar politika ekonomike *ad hoc*, sipas rastit, sipas stadi apo sipas ciklit të zhvillimit ekonomik dhe tashmë ajo i ka të gjitha kapacitetet e krijuara edhe me mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar për ta bërë pikërisht këtë rol të ri.

Projekti i Bankës së Shqipërisë për strategjinë 2018-2020 mbështetet pikërisht në këtë rol të ri të Bankës së Shqipërisë. Sfidat janë shumë të mëdha, tregjet financiare janë të gjitha në lëkundje. Banka e Shqipërisë, sikundër edhe shumë banka të tjera, po përplasen dhe po përballen edhe me format e reja të monedhave, të tregjeve, të tregjeve dhe monedhave virtuale, të cilat kërkojnë një parashikim dhe studime shumë të thelluara në mënyrë që këto goditje që vijnë nga tregjet financiare të mos shkaktojnë turbullira në tregjet dhe ekonominë reale.

Besoj se Banka e Shqipërisë do ta luajë më mirë rolin e vet me politikën monetare si një nga instrumentet themelore për të krijuar stabilitet makro-ekonomik. Deri tani politika monetare ka qenë relativisht më e shtrënguar dhe më e tërhequr, pasi fokusin e ka pasur më shumë politika fiskale.

**Erion Braçe** – A mbaruat, zonjë?

Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët deputetët?

Ky është prezantimi i dytë i zonjës, sepse kemi qenë bashkërisht këtu kur është bërë edhe prezantimi personal edhe ai i vizionit për Bankën e Shqipërisë. Në rast se keni ndonjë pyetje mund ta adresoni, në rast se nuk ka pyetje do të vijojmë?

Nuk ka pyetje.

Zonja Minxhozi, shumë faleminderit për prezantimin tuaj. Do të doja t’ju kujtoja që në respekt edhe të ligjit për konfliktin e interesit, çdo veprimtari tjetër në borde e të tjera me radhë do të ndërpritet që nga në momenti kur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ju jep mandatin për të qenë anëtare e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

**Luljeta Minxhozi** – Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit juve!

Vijojmë me kandidatin tjetër.

Zoti Hoxha, faleminderit për prezencën tuaj!

Pas interesimit tuaj për të qenë një nga kandidatët e mundshëm për vendet vakante në Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë që adreson Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, doja t’ju njoftoja se Kuvendi dje ka marrë një propozim mbështetës nga 28 deputetë të tij, gjithmonë në funksion të kandidaturës suaj për të qenë një anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Pikërisht për këtë arsye ju jeni sot i pranishëm këtu. Në fakt, ju e keni bërë një prezantim tuajin individual, por edhe të vizionit tuaj në përmbushje të këtij funksioni në Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, por megjithatë ky komision ka detyrimin të dëgjojë edhe një herë opinionet dhe vizionit tuaj në rast se ju do të merrni mandatin në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ditën e enjte, për të qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Prezantimi juaj profesional dhe personal është kryer në një seancë tjetër.

Fjala për ju.

**Artan Hoxha** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në radhë të parë dua të falënderoj deputetët që kanë mbështetur kandidaturën time! Do të doja t'ju falënderoja edhe ju për kohën, duke dëgjuar disa momente, të cilat mendoj se mund të jenë me interes për komisionin dhe për vazhdimin më tej të kandidaturës sime për anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Vizionin dhe disa nga elementet që kanë të bëjnë me kandidimin tim, ashtu sikurse e thatë edhe ju, i kam parashtruar në një mbledhje të mëparshme të dëgjesës së parë, prandaj do të doja t'ju thosha 2-3 gjëra.

E para, po ju them diçka për veten time. Kam një eksperiencë të gjatë dhe përvojë në fushën e drejtësisë. Prej 35 vjetësh punoj si jurist me kohë të plotë në fusha të ndryshme të së drejtës. Kam mbuluar detyra të rëndësishme si anëtar i Gjykatës së Lartë për 9 vjet me një mandat të plotë, anëtar i Kolegjit Penal, anëtar i Kolegjit Civil, kryetar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Prej 10 vjetësh punoj me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës dhe aktualisht drejtoj Fakultetin e Drejtësisë së këtij universiteti prej 2 vjetësh me votën e pedagogëve dhe të studentëve të këtij universiteti.

Mendoj se përvoja ime me profesionin si jurist do ta ndihmonte veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë në disa elemente që janë tipikisht për juristët, si: zbatimi me korrektesë i ligjit, kuptimi në radhë të parë i tij, i cili do ta orientonte këshillin, i cili në përbërjen e tij ka kryesisht ekonomistë, me një mendim, i cili është alternativ me mendimin e një profesioni tjetër që nuk është në kundërshti, por mendoj se Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka nevojë për pjesëmarrjen e juristëve në përbërjen e tij.

Një jurist ka një mendim dhe një interpretim më të qartë për ligjin dhe kupton, do të thosha në parim, jo subjektivisht, më qartë situata të caktuara, të cilat duhet të përputhen me ligjin dhe kërkojnë interpretimin juridik të tij. Unë mendoj se qenia e një juristi në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës do të eliminonte edhe paqartësi apo situata, të cilat Këshilli i mëparshëm Mbikëqyrës apo diçka më parë i tij ka hasur në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Ju në dëgjesën e parë më pyetët se çfarë rregullimesh të mëtejshme mund të ketë në ligjin për Bankën e Shqipërisë? Aktualisht, shoh një problematikë, pa hyrë më shumë në detaje. Në radhë të parë, Banka e Shqipërisë duhet të jetë një institucion i pavarur, gjë të cilën e deklaroi edhe ligji dhe kjo gjë duhet bërë që të jetë i garantuar dhe jo vetëm i deklaruar. Kur shoh shkaqet e largimit ose të pezullimit të një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë, ka një

lloj ose më saktë është më pak garantuese sesa funksionet e tjera që kërkojnë pavarësi të një organizmi. Sipas mendimit tim, një përcaktim më i saktë i rasteve kur anëtari i Këshillit Mbikëqyrës largohet ose pezullohet nga detyra, mund të jetë i rishikueshëm për të garantuar pavarësinë e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Bankës nëpërmjet anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Gjithashtu, vura re edhe diçka tjetër. Në nenin 72 thuhet: “Çdo subjekt juridik ose fizik i cenuar nga shkeljet e pretenduara të këtij ligji nga ana e Bankës së Shqipërisë, ka të drejtë t’i kundërshtojë ato përpara Gjykatës së Apelit”. Sipas meje kjo është e diskutueshme, sepse në një riorganizim që i është bërë sistemit gjyqësor në Shqipëri me ndryshimet kushtetuese është shumë e rëndësishme që dy shkallë gjykimi të jenë të plota, gjykimi në Shkallë të Parë dhe gjykimi në Apel, pasi Gjykata e Larta tashmë nuk e ka si objekt të veprimtarisë së saj zgjidhjen e çështjeve, por vetëm unifikon praktikën gjyqësore nëpërmjet çështjeve që i vijnë asaj. Pra, një gjykim me një shkallë dhe kthimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë si Gjykatë e Shkallës së Parë, nuk shkon përgjithësisht me teknikën dhe mënyrën se si shkohet në gjykatë përgjithësisht, prandaj nuk ka pse në këtë rast të jetë i ndryshëm.

Ka edhe një disponim në nenin 75 të ligjit, në të cilin thuhet: “Shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje sipas ligjit për bankën”. Kjo është një dispozitë shumë e hapur, blankete, referuese dhe shkelja e çdo dispozite të këtij ligji nuk mund të përbëjë kundërvajtje. Përcaktimi i kundërvajtjeve duhet të jetë në një dispozitë konkret dhe të thuhet: “Shkelja e kësaj dispozite apo asaj dispozite sjell këtë pasojë dhe kjo vjen sipas këtij rregullimi”. Pra, thënia në këtë mënyrë është sikur të mos thuash asgjë ose të jesh shumë subjektiv në përcaktimin e përgjegjësiave konkrete. Këtë e mora si detyrë shtëpie nga dëgjesa e parë pa hyrë në elementet ekonomike, por në elementin juridik mendoj se janë disa dispozita, të cilat me përpunimin e tyre e garantojnë më mirë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe të Këshillit të saj Mbikëqyrës.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit, zoti Hoxha!

A ka pyetje? Jo.

Për ta mbyllur, duke shkuar prapë tek ajo kërkesa apo te detyra e shtëpisë, me sa duket Kuvendi do të shkojë drejt konfirmimit tuaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, zoti Hoxha. Meqë ne nuk ia kemi dalë thujse për vite të tëra, jo thjesht tani, meqenëse ka një kërkesë insistuese, veçanërisht të atyre që janë konsumatorë të shërbimeve bankare e të tjera me radhë, do të preferonim të kishim pa asnjë lloj diskutimi kontributin tuaj në rritjen e transparencës të

marrëdhënieve midis sistemit bankar dhe cilitdo konsumatori. Kjo është një ndër pikat kyçe që ne si Komision i Ekonomisë e kemi theksuar vazhdimisht, është edhe në rezolutat ton dhe natyrisht edhe prezenca juaj në Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë do të duhet ta adresojë një problematikë të tillë.

Shumë faleminderit për prezencën dhe kontributin tuaj!

**Artan Hoxha** – Faleminderit juve dhe punë të mbarë!

**Erion Braçe** – Më falni, do të doja t’ju bëja me dije që kandidati tjetër, zoti Malaj, nuk ndodhet në Shqipëri, kështu që pavarësisht propozimit të bërë nga grupi i deputetëve ne do të duhet ta zhvillojmë seancën dëgjimore me të dhe më pas t’ia përcjellim Kuvendit për të marrë edhe ai vendimet e veta dhe konfirmimin edhe për këtë kandidat për të qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Zoti Malaj, ka kërkuar leje me shumë mirësjellje, prandaj mbledhjen do ta zhvillojmë një ditë tjetër, për vijimin e punës së zotit Malaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Faleminderit të gjithëve!

Mbledhja për ditën e sotme mbyllet këtu.

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretar**  
**Anastas Angjeli**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit**  
**Elvi Prifti**